

Vendim nr. 191 datë 23.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 23.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ERVIS ALLA, përfaqësuar me prokurë nga avokat Lazër Sokoli

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-179, datë 08.02.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 27, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. 69 të vitit 2016 në ngarkim të të pandehurve S.D. dhe Ervis Alla (*kërkuesi*), të akuzuar për kryerjen e veprën penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, në bashkëpunim (të kryer ndaj tre shtetasve), të parashikuar nga nenet 109/b, paragrafi i parë dhe 25 të Kodit Penal (*KP*). Gjykimi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është zhvilluar sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 47, datë 29.05.2017, ka vendosur, mes të tjerave, deklarinim fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” (të kryer ndaj tre shtetasve), në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 109/b, paragrafi i parë dhe 25 të KP-së dhe në bashkim të dënimeve, për shkak të kryerjes tre herë të së njëjtës vepër penale, dënimin përfundimisht me pesë vjet e tetë muaj burgim. Bazuar në nenin 406, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) është vendosur përfundimisht dënimi me tre vjet e tetë muaj burgim dhe llogaritja e tij ka filluar nga data 12.05.2016, dita e arrestimit.

3. Kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, e cila me vendimin nr. 104, datë 14.12.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 47, datë 29.05.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

4. Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda kërkuesi ka ushtruar rekurs në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, i cili me vendimin nr. 00-2024-179, datë 08.02.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit.

5. Kërkuesi në datën 13.06.2024, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pas plotësimit me dokumente sipas nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar përfundimisht në datën 28.06.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

6.1. *Parimi i prezumimit të pafajësisë* i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi është deklaruar fajtor vetëm mbi bazën e të dhënave të marra në mënyrë të paligjshme dhe nuk është vërtetuar fajësia. Nga analiza tërësore e akteve nuk rezulton prania e një prove direkte ose indirekte për të arritur në përfundimin e një vendimi fajësie për kërkuesin.

6.2. *Parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi çështja duhet të kalonte për njësimin e praktikës gjyqësore lidhur me standardin e provueshmërisë

përtej çdo dyshimi të arsyeshëm në dhënien e një vendimi fajësie. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga tri gjyqtarë për njësimin e praktikës duhet ta kalonte çështjen për gjykim në Kolegjin Penal të përbërë prej 5 anëtarësh.

6.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat kanë arritur në përfundimin për deklarimin fajtor të kërkuesit pa asnjë provë dhe në dhënien e vendimit ato duhet të bazohen në provat e marra gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në rekurs janë parashtruar pretendime me natyrë kushtetuese dhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar në lidhje me çështjen e fajësisë së kërkuesit. Në procesin penal barrën e provës e ka organi i akuzës dhe kur hetimi nuk është bërë i plotë, është gjykata që merr rol aktiv duke kërkuar prova. Në rastin konkret çështja është gjykuar me gjykim të shkurtuar, por pavarësisht kësaj, gjykatat kanë detyrim për të respektuar parimet bazë ku mbështetet legjislacioni penal, mbi të gjitha të drejtën për proces të rregullt ligjor.

6.4. *E drejta e aksesit në drejtësi*, pasi nuk është marrë përgjigje për pretendimet dhe nuk ka pasur një zgjidhje përfundimtare për çështjen.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse objekt i ankimit kushtetues individual është procesi gjyqësor në përfundim të të cilit ai është dënuar penalisht për disa akuza, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike nënkupton jo vetëm që kërkuesi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t’i drejtohet Gjykatës, por edhe që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 13.06.2024, ndërsa vendimi gjyqësor më i fundit që kundërshtohet prej tij është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 08.02.2024, por është bërë i disponueshëm për palët në datën 14.02.2024, bazuar në informacionin e dërguar nga Gjykata e Lartë. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nëpërmjet shërbimit postar në datën 13.06.2024 është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka parashtruar pretendime për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, të gjyimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit.

13. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë kërkuesi ka pretenduar se është deklaruar fajtor vetëm mbi bazën e të dhënave të marra në mënyrë të paligjshme dhe nuk është vërtetuar fajësia. Sipas kërkuesit, nga analiza tërësore e akteve nuk ka rezultuar prania e një prove direkte ose indirekte për të arritur në përfundimin e një vendimi fajësie.

14. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit çmuarja e provave, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese

të individit për proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, si dhe të çmuarjes së provave për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 45, datë 23.07.2012; nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në këndvështrim të standardeve kushtetuese Kolegji vlerëson se argumentet e kërkuarit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë kanë të bëjnë me vlerësimin e provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë nuk hyjnë në sferën e juridiksionit kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim.

16. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj kërkuari ka parashtruar se çështja e tij duhet të kalonte për shqyrtim në Kolegjin e përbërë nga pesë gjyqtar, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore. Kolegji vlerëson se kjo është një çështje e mënyrës së zbatimit të ligjit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili kryesisht ose me kërkesë të palëve vlerëson nëse në një çështje të caktuar është përpara rastit për të nisur procedurën e gjykimit për të njësuar praktikën, sipas nenit 438 të KPP-së. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj kërkuari nuk ka parashtruar argumente kushtetuese dhe nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit, Kolegji vlerëson se në thelb lidhet me respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi sipas kërkuarit ai nuk ka marrë përgjigje për shkaqet e parashtruara në rekurs. Pretendimet e kërkuarit *prima facie* hyn në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohet së bashku në vijim nga Kolegji.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

18. Kërkuari ka pretenduar se gjykatat në dhënien e vendimit duhet të bazohen në provat e marra gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar në lidhje me çështjen e fajësisë dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese. Pavarësisht se çështja është gjykuar me gjykim të shkurtuar, gjykatat kanë detyrim për të respektuar parimet bazë ku mbështetet legjislacioni penal.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e

gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 5, datë 22.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret, nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka rezultuar se për kërkuesin është vendosur deklarimi fajtor për veprën penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” (e kryer ndaj tre shtetasve), në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 109/b, paragrafi i parë dhe 25 të KP-së dhe në bashkim të dënimeve, për shkak të kryerjes tre herë të së njëjtës vepër penale, dënimin përfundimisht me pesë vjet e tetë muaj burgim. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në dhënien e vendimit të saj i është referuar dëshmive të të pandehurve, të disa personave, provave materiale, provave të dokumentuara në raporte, ku pasqyroheshin përgjimet në vende publike, filmimet me video dhe audio të lëvizjeve, takimeve e të dhënave nga kompanitë telefonike dhe rezultatit të përgjimeve të komunikimeve telefonike. Me të njëjtin arsyetim edhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (*shih faqet 7-20 të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda*).

23. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vlerësuar se referuar shkaqeve të rekursit nuk ka vend për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Kolegji Penal ka vijuar në arsyetim se Gjykata e Apelit për Krime të Rënda i ka dhënë përgjigje të argumentuar, duke i ka trajtuar pretendimet e kërkuesit dhe se fakti që konkluzionet e gjykatës së apelit dhe të shkallës së parë nuk përputhen me pretendimet e kërkuesit në lidhje me fajësinë, nuk do të thotë se vendimi i rekursuar është i paarsyetuar. Gjithashtu, Kolegji ka theksuar se gjykatat e faktit kanë pranuar kërkesën për vazhdimin e gjykimit me procedurën e gjykimit të shkurtuar, çka kupton se dosja e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore. Për rrjedhojë, në përfundim, Kolegji Penal ka vlerësuar se rekursi nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432, pika 1, të KPP-së, duke vendosur në përfundim mospranimin e tij.

24. Bazuar në standardet kushtetuese dhe referuar në tërësi përmbajtjes së vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Kolegji vlerëson se i përmbush elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Ai ka respektuar elementet formale, duke pasqyruar të dhënat e palëve në procesin gjyqësor penal, shkaqet e parashtruara në ankimin dhe rekurs, vendimet e gjykatave më të ulëta, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ka mbështetur qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Gjithashtu, duke pasur parasysh natyrën e vendimit të mosprimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të marrë në dhomën e këshillimit, mënyra e arsytimit të tij nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, për sa kohë ai u ka dhënë përgjigje edhe pretendimeve të kërkuesit të parashtruara në rekurs në lidhje me vlerësimin e provave për marrjen e vendimit për fajësinë e tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.